



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

RELACIONI
PËR RISHIKIMIN E INSTRUMENTIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.

Z. EDI RAMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Znj. RAIMONDA NASE

Kryetari i Bashkisë

Z. SOTIRAQ FILO



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 9, Datë 03.12.2014

Relacion mbi korrektimin e rrjetit rrugor të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë

Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendim KKT, nr. 13, datë 7.3.2014, parashikon zhvillimin e qytetit në 10 vitet e ardhshme, me bazë kriteret dhe standartet të mirëpërcaktuara. Pjesë e tij është dhe pasqyrimi i rrjetit rrugor ekzistues dhe zhvillimit perspektiv të tij.

Për shkak të rolit të saj qendror në jetën urbane kërkesa për qasje të motorizuara në qendër të qytetit është më e lartë se në të gjitha zonat urbane. Qendra e qytetit është pjesa vitale, tregtare dhe gjeografike e një qyteti dhe është me rëndësi të madhe në konceptin e madh urban, si bazë për aktivitetin e jetës urbane ekonomike dhe sociale në qytet. Për shkak të rolit thelbësor që luan qendra e qytetit në sistemin urban dhe rëndësinë e saj si dritare e qytetit, si një zonë integrale ajo karakterizohet nga cilësi e lartë mjediseve publike dhe hapësirave të hapura që krijojnë hapësira të këndshme, e të rehatshme dhe të qëndrueshme sociale. Sheshet e trotualet dhe pika të tjera që takohen në qendër të qytetit duhet të zhvillohen në një mënyrë që inkurajojnë ndërveprimin shoqëror dhe të mundësojnë aktivitetet e bashkisë dhe aktivitetet në qendër të qytetit. Sigurimin që rrugët e qendrës së qytetit të përdoren miqësisht është me rëndësi stimulimi dhe promovimi i jetës urbane për të promovuar imazhin e qytetit. Ndriçimi dhe pajisja e rrugëve duhet të përfshijë veshjen e duhur, basenet ujore, vendet e reklamimit, sinjalet rrugore, si dhe kështu me radhë duke siguruar për nevojat e infrastrukturës duke përfshirë vend nyjet e transportit publik, nyjet elektrike dhe ku është e mundur të kombinuara me njëra-tjetrën.

Rrugët e qytetit dhe rrjeti rrugor janë komponent përbërës të sistemit të gjerë urban dhe luajnë një rol qendror në mbështetjen e zhvillimit të ardhshëm duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi dhe i lidh ato me zonat ekzistuese. Kjo bëhet akoma më e nevojshme në kuadër të Reformës Territoriale, e cila parashikon që qyteti i Korçës të jetë qendër administrative dhe për një numër të madh fshatrash si, Dardha, Voskopoja etj..

Më poshtë detajohen dy parime gjithëpërfshirëse të zhvillimit të cilat udhëzojnë stafin bashkiak në ofrimin e një hierarkie të integruar të rrjetit rrugor dhe që ofrojnë një përgjigje të përshtatshme për nevojat e transportit dhe lëvizjes në qytet. Këto parime marrin në konsideratë aspekte të ndryshme të zgjidhjeve urbanistike, si të gjithë qytetin, rajonin dhe ato lokale që aspirojnë për të arritur standartet e BE për secilin nga komponentet e ndryshme të rrugëve që përfshin rrugët e këmbësorëve, trotualet dhe ambjentet e parkimit etj.

▪ Hierarkia e Rrugëve:

Zhvillimi i hierarkisë së rrugëve është një nga dy parimet e zhvillimit për rrjetin e rrugëve. Zbatimi i një hierarkie të rrjetit rrugor, kontribuon për funksionimin e saj efikas dhe përmirëson orientimin e banorëve dhe vizitorëve brenda sistemit urban. Komponentë të ndryshëm të hierarkisë së rrugëve të detajuar më poshtë janë të bazuara në standartet aktuale dhe funksionale Shqiptare dhe ato ndërkombëtare të projektimit për t'i shërbyer fluksit të ndryshëm të trafikut në përputhje me rolin e rrugëve në sistemin urban:

- *Rrugët Kryesore Urbane*

- Funksionojnë në të njëjtën kohë si lidhëse të nyjave kryesore urbane, qendrore dhe ato me popullsi të dendur dhe si arterie qendrore e trafikut, duke shkuar rreth ose nëpërmjet qytetit.
- Përveç rolit të tyre në kuadër të rrjetit të transportit, rrugët kryesore urbane të shërbejnë edhe si akse të rëndësishme infrastrukturore. Infrastruktura kryesore urbane të tilla si tubacionet dhe kabllot e tensionit duhet të jenë të sistemuara së bashku dhe të vendosen nën rrugët kryesore urbane të cilat mund të përdoren si korridoret e infrastrukturës

- *Rrugët Dytësore Urbane*

- Funksionojnë si rrugë arteriale primare në një lagje në shërbim të komunitetit lokal më shumë se rrugë hyrëse qyteti dhe shërben si aks qendror në hyrje daljet e lagjeve, që lidhin sistemin rrugor urban me atë të rrugëve dytësore.

- *Rrugët e Lagjeve (rrugët lokale)*

- Plotësojnë rrugët kryesore të lagjeve dhe të trafikut të drejtpërdrejtë në banesat e qytetarëve, e përdorur pothuajse vetëm nga banorët që jetojnë përreth tyre.
- Duhet të rregullohen si rrugë një kalimshe me vend kalim për këmbësorë dhe të paktën vend parkim për automjete
- Ku ndarja efektive e këmbësorëve dhe automjeteve lëvizëse të trafikut është praktikisht e pamundur, mund të lejohet përdorim i përbashkët.

- *Rrugët Historike*

Ndërtuar para përdorimit të mjeteve të motorizuara. Veshur me gurë dhe që vuajnë nga mungesa e karakteristika të tjera të tilla si trotuar apo vende parkimi për automjete. Duhet të përdoren si rrugët qasje në pjesët historike të qytetit të ndara nga trafikut lokal dhe aktiviteti i këmbësorëve.

- *Rrugët Vetëm për Këmbësorë*

Rrugët vetëm për këmbësorë janë të mbyllura për trafikun e automjeteve - ose në çdo kohë ose gjatë orarit të përcaktuar. Rrugët e këmbësorëve janë zgjidhja më e mirë në zonat tregëtare me pakicë (dhe më pak për zonat e banimit), sepse ata përjetojnë rrjedhën e rënduar për këmbësorë dhe jetën aktive urbane. Në përputhje me rrethanat duhet të konsiderohen qasje për ofrimin e automjeteve.

▪ **Rrjeti Rrugor i Integruar**

Parimi i zhvillimit të integruar të rrjetit rrugor është i drejtuar drejt krijimit të një rrjeti rrugor i cili funksionon si një pjesë integrale e indeve urbane. Të dhënat e mëposhtme detajojnë shtatë parimet e zhvillimit të integruar të rrjetit rrugor të cilat janë për t'u përdorur nga ana e stafit bashkiak në krijimin e një rrjeti të integruar rrugor në qytet.

- *Rrugë të Sigurta* – Faktorët e sigurisë duhet të jenë të integruara në zhvillimin e rrjetit rrugor, me theks të veçantë për grupet e rrezikuara të tilla si fëmijë, personat me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarve

- *Lëvizje e Lehtë* – Zhvillimii rrjetit rrugor duhet të sigurojë lëvizje efektive të njerëzve dhe mallrave në një rrjet të gjerë të mënyrave të transportit (për shëtitjen, për përdorimin e biçikletave, transportin publik, veturat etj), nëpërmjet sigurimit të objekteve të rehatshme dhe

të përshtatshme si vend sistemim biçikletash, vend stacion autobuzash, dhe trotuare të përshtatshme.

- *Reflekton Kontekstin e tyre* – Zhvillimi i rrjetit rrugor duhet të zbatohet në një mënyrë që ruan karakterin e lagjeve përmes projektimit dhe menaxhimit me kujdes dhe përdorimit të mjeteve për zbutjen e trafikut.

- *Rrugë të Përshtatshme* – Zhvillimi i rrjetit rrugor duhet të marrë parasysh rolin e rrjetit rrugor, si një hapësirë e rëndësishme e hapur brenda qyteteve që siguron ndërveprimin social, qytetar dhe ekonomik.

- *Rrugë të Qëndrueshme* – Hapësira relativisht e gjerë në mes të ndërtesave që është dhënë nga rrjeti rrugor duhet të përdoret në kuadër të procesit të zhvillimit për të rritur shëndetin mjedisor urban nëpërmjet shtimit të vegetacionit, reduktimit të sipërfaqeve të papërshkueshme, kontrollit të ujërave të bardha etj

- *Rrugë Tërheqëse* – Një rrjet rrugor me mjedis tërheqës duhet të zhvillohet përmes përdorimit të materialeve dhe teksturës të qëndrueshme për krijimin e panoramave shumë estetike.

- *Rrugë Ekonomike* – Zhvillimi i një rrjeti rrugor duhet të sigurojë qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë ekonomike të rrugëve duke marrë në konsideratë nevojat e të ardhmes së qytetit (rritjen e modelit të trafikut, mënyrën e jetesës të popullsisë apo të gjithë avancimet teknologjike).

Parimet e Zhvillimit të Infrastrukturës

Sipas rishikimit të fundit të Sektorit Urban nga Banka Botërore, konteksti i përmirësimit të infrastrukturës, u vlerësua të jetë një faktor kyç në zhvillimin e ardhshëm të qyteteve në Shqipëri. Gjendja aktuale e shumicës së infrastrukturës kërkon investime të medha fillestare dhe menaxhim afat gjatë dhe mirëmbajtje të vazhduar. Bazuar në sa më sipër, është formuluar një listë e parimeve të zhvillimit të infrastrukturës të cilat janë drejtuar drejt krijimit të shërbimeve bashkiake me cilësi të lartë.

▪ Zhvillim i Integruar i infrastrukturës:

Grupimi i proceseve të zhvillimit të infrastrukturës në një projekt të integruar infrastrukture shumë-sektoriale, sipas konceptit të caktuar hapësinor dhe nevojat e qytetit, do të rrishte efikasitetin e kostos me ofrimin e shërbimeve të plota dhe do të bente të mundur një fleksibilitet më të madh në afrimin e donatorëve të ndryshëm për fondet.

▪ Trajtimi gjithëpërfshirës:

Zhvillimi i komponentëve të ndryshme të infrastrukturës urbane duhet të ofrojë një zgjidhje të përgjithshme të zhvillimit ekzistues dhe të ardhshëm të qytetit. Si i tillë, duhet të zhvillohet në mënyrë gjithëpërfshirëse master plani, për secilin nga rrjetet e infrastrukturës bashkiake.

Në bazë të studimeve gjithëpërfshirëse, analizave të kërkesave aktuale dhe të perspektivës, si dhe koordinimit të master planit përkatës urbanistik.

▪ **Niveli i Shërbimit:**

Zhvillimi i komponentëve të ndryshëm të rrjetit të infrastrukturës duhet të maksimizojë nivelin e shërbimit të banorëve të qytetit dhe t'u përmbahet standardeve relevante kombëtare dhe ndërkombëtare.

Bazuar në sa më sipër, bashkia Korçë parashikon rikonstrukcionin dhe zgjerimin e rrugës "Don Gjon Buzuku" si prioritet në investimet e vitit 2014, miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 85, datë 16.09.2014. Kjo rrugë është parashikuar të zhvillohej që në vitet 1960 dhe ka qenë pjesë e të gjitha Planeve Rregulluese të hartuara në vitet në vazhdim për qytetin e Korçës si një arterie e rëndësishme e tij. Duke parë që për arsye shpronësimesh megjithëse e parashikuar shumë herët kjo rrugë nuk është realizuar, nga firma hartuese e IPV nuk është pasqyruar në propozimet e rrjetit të ri rrugor të qytetit.

Kërkesa për transformimin e qyteteve dhe rivitalizimin e qendrave të tyre, sjell domosdoshmërinë për përfshirjen e këtij projekti në prioritetet e Bashkisë Korçë dhe realizimin e këtij investimi, i cili do të përmirësojë jo vetëm qarkullimin e mjeteve dhe të këmbësorëve por edhe do të rigjenerojë mjedisin urban të kësaj zone qendrore të qytetit.

Rruga "Don Gjon Buzuku" ndodhet në pjesën jugore të zonës qendër të qytetit dhe sipas IPV, kjo rrugë ndodhet në zonën A4.3 "qendra e qytetit – zgjerim". Rruga lidh Bulevard "Fan Noli" me rrugën "28 Nëntori" dhe do të funksionojë si vazhdim i Bulevard "Republikës". Përgjatë saj ndodhen dy institucione të rëndësishme për qytetin si "Radio-Televizioni Korça" dhe shkolla e muzikës "Tefta Tashko Koço". Rruga "Don Gjon Buzuku" krijon një lidhje direkte të qendrës së qytetit me rrugën e Ersekës dhe zonën informale në të dy krahët e saj, e cila ka dhe numrin më të madh të ndërtimeve informale në qytet.

Projekti i zgjerimit të rrugës "Don Gjon Buzuku", ka për qëllim rregullimin e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve në këtë rrugë mjaft të rëndësishme për qytetin. Ndërhyrja parashikon rikonfigurimin e rrugës, me zgjerimin në rrugë me dy korsi kalimi për automjetet, një korsi parkimi, një korsi biçikletash si dhe trotuare në të dyja krahët.

Projekti parashikon një ndërhyrje të plotë në rrugë duke realizuar rrjetin e kanalizimeve, kullimin e ujrave të shiut, ndriçimin, gjelbërimin, sinjalistikën rrugore si dhe elementë të tjerë të mobilimit urban dhe krijon në këtë mënyrë jo vetëm funksionalitet por dhe një ambient bashkëkohor për qendrën e qytetit.

Gjatësia e kësaj rruge do të jetë 270 m, gjerësia e përgjithshme e rrugës 16 m, sipërfaqja e asfaltit 4800 m², sipërfaqe trotuari 1 500 m², sipërfaqja totale që sistemohet është 10 500 m².

Zhvillimi i propozuar është pjesë përbërëse e infrastrukturës së zones. Infrastruktura ekzistuese e ujësjellësit do të ruhet, kurse ajo e kanalizimeve do të zëvendësohet në kuadër të projektit. Ndërhyrjet parashikojnë investime në rrjetin e kanalizimeve të cilat do të kryhen

nga UKKO, kurse lidhja për furnizimin me energji elektrike për ndriçimin do të kryhet nga rrjeti ekzistues.

Zona e përzgjedhur ka nevojë për këtë ndërhyrje bazuar në nevojën qytetare për një mjedis më cilësor dhe tërheqës. Kontraktori i zbatimit të projektit do të kryejë aktivitetin duke marrë masa konkrete për mbrojtjen e tokës, ujrave nëntokësore, asgjesimin e mbetjeve, minimizimin e nivelit të zhurmave, për eliminimin e ndotjeve në ajër dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta. Inertet nuk do të përdoren. Ato do të transportohen në vendet e aprovuara nga Bashkia për hedhjen e tyre.

Projekti trajton rrethimin e pronave të ndodhura përgjatë rrugës duke parashikuar ndërtimin e xokolaturës prej guri sipas modelit të bulevard “Republikës” si vazhdim i së cilës ajo është dhe vendosjen e kangjellave tradicionale të qytetit.

Shtrirja e rrugës në vijë të drejtë përmirëson ndjeshëm peisazhin e saj duke krijuar një fushëpamje të plotë si në drejtim të qendrës së qytetit (Sheshi i Katedrales dhe Blvd. “Republika”) , dhe të rrugës “28 Nëntori”. Gjelbërimi rrugor dhe ndriçimi bashkëkohor do të jenë elementët kryesorë përbërës për përmirësimin e peisazhit.

Korrektimi në Rrjetin Rrugor të qytetit, me parashikimin e rrugës “Don Gjon Buzuku” si rrugë dytësore urbane, rrit standartet në qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve, në lidhjen e qendrës së qytetit me zonën informale të rrugës së Ersekës si dhe me zonat turistike për rreth (Dardha, Vithkuqi etj.) dhe në lehtësimin e fluksit të lëvizjes të qendrës drejt rrugëve dytësore lokale.

**Drejtoria e Planifikimit dhe
Kontrollit të Zhvillimi të Territorit**

BASHKIA KORÇË